

Forma e kryerjes së umras sipas sunetit të saktë profetik

Shkëputur nga "Menasikul haxh vel umrah"/"Haxhi Profetik" i dijetarit të madh Imam Albanit (Allahu e mëshiroftë!),
"Nubdhetu et tahkik" e shejh Ali el Halebij si dhe nga "El Meusuatul fik'hijeh" e shejh Husejn el Avajshe

Përktheu: Xhabir SHEME



1. Nijeti.

Nuk lejohet të shqiptuarit e nijeti me gojë

2. Veshja e *ihramit*.

Kur të mbërrish te *mikatet*/vendet e përcaktuara¹ për veshjen e *ihramit*, lahu dhe parfumohu me erë të mirë vetëm në trup e pastaj vish rrobën e *ihramit*. Burri vesh *izar* (copë që vendoset nga mezi e poshtë) dhe *ridaen*, kurse gruaja nuk vesh ndonjë rrobe të posaçme dhe me ngjyrë të caktuar, por vesh po atë veshje që është ligjëruar asaj, duke iu larguar nikabit dhe veshjes së dorashkave. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Gruaja që ka veshur *ihramin*, nuk vendos nikab dhe nuk vesh dorashka.”
(*Mutefekun alejhi*. "Sahihu Ebi Daud 1600")

Kujdes: Pas veshjes së *ihramit*, nuk lejohet të parfumohesh me parfum, nuk lejohet prenja e thonjve dhe shkurtimi i flokëve.

3. Gruaja e mbulon fytyrën e saj dhe duart nga personat e huaj duke mos përdorur dorashka dhe nikab, por, kujdes ... kujdes, oj motër, nga të zbuluarit e këmbëve.

¹ Transmetohet nga Abdullah ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) përcaktoi vendin e quajtur "Dhul Hulejfe" për banorët e Medines. Për banorët e Shamit caktoi "El Xuhufe". Për banorët e Nexhdit "Karne el Menazil". Për ata të Jemenit "Jelemlem". Këto vende janë për këta banorë dhe për të tjerët që kalojnë nga ato kur shkojnë për haxh apo për umra. Ndërsa për ata që banojnë më pranë Mekës se këto vende, atëherë vendi i *ihramit* të tyre është vendnisja e tyre. Po kështu edhe banorët e Mekës (e bëjnë nijetin dhe veshin *ihramin*) nga shtëpitë e tyre." (Buhariu (1524), Muslimi (1181), etj.)

4. Transmetohet nga Abdullah bin Umer (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se një burrë tha: "O i Dërguari i Allahut, çfarë rrobash i lejohet *muhrimit* te veshë?" I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: "Atij nuk i lejohet të veshë as këmishë, as *imame* (çallmë a të ngjashme me të), as shallvare, as xhybe, as shoshone (çizme), përveç atij që nuk gjen sandale (apo pantofla); ky të veshë shoshone, por t'i presë ato poshtë kyçeve të këmbëve, dhe të mos veshë rrobe të cilat i ka prekur *zeaferani* (bimë për ngjyrosjen e rrobave) dhe parfumi."²
5. Gjëja më e mirë është që rroba e *ihramit* të vishet që në Medine ashtu siç ka vepruar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Lejohet heqja dhe ndërrimi i rrobës së *ihramit*, nëse ajo ndotet/bëhet pisë.
6. Fillimi i ritualit të umras fillon që nga *mikadet*, nga Dhul Hulejfe për atë që niset nga Medina.
7. Pas veshjes së *ihramit*, fal dy rekate në fushën e quajtur "El Akik". Këto dy rekate nuk janë rekate të posaçme për veshjen e *ihramit* siç mendojnë disa njerëz. Allahu e mëshiroftë atë person që e ringjall këtë sunet (faljen e dy rekateve në fushën "El Akik"), sepse shumica e njerëzve e kanë lënë. *Allahu el mustean!*
8. Pastaj qëndro i drejtuar nga Kibla dhe thuaj:

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ بِعَمْرَةٍ لَا رَاءَ فِيهَا وَلَا سَمْعَةَ، اللَّهُمَّ مَحَلِّي حَيْثُ حَبَسْتَنِي

"Lebejke Allahumme biumrah la rajae fiha ve la sumah, Allahumme mehili hajthu habesteni"

9. Pastaj fillo me *tebjeh* duke e ngritur zërin

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ

"Lebbejke Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike lek, lebbejk, innel hamde ven niameh leke vel mulk la sherike lek/Të përgjigjem Ty, O Zoti im, të përgjigjem! Të përgjigjem Ty, dhe Ti je i Pashoq. Falënderimi të takon vetëm Ty dhe Mirësia është vetëm prej Teje. Vetëm i Yti është edhe sundimi. Ti je i Pashoq". {Buhariu me *Fet'h* në "Babu et Tebjeh" 1549 nga Abdullah bin Umer. Po ashtu, edhe nga Aisha me nr. 1550}.

² Buhariu (134), Muslimi (1177), etj.

10. Burrat gjatë thënies së saj e ngrijnë zërin e tyre ndërsa gratë e thonë me zë të ulët. Po ashtu, lejohet të thuash edhe *“Lebejke dhal mearixh lebejke dhal fevadil”* dhe *“Lebejke ilahel hak”*. Ndërsa Abdullah bin Umer shtonte: *“Lebejke lebejke. Ue seadejke. Uel hajru bijedejke, uer ragbau ilejke uel amelu”*/ Të përgjigjem Ty, të përgjigjem dhe të përgjërohem! E mira është e gjitha në Duart e Tua dhe kërkesa jonë drejtohet vetëm tek Ty, edhe vepra jonë.³ Nuk lejohet në asnjë mënyrë që *telbijeh* të bëhet bashkërisht/me xhemat, por secili më vete.
11. Hyrja në Meke.
- Kur të futesh në xhaminë e shenjtë/Kabe, thuaj lutjen e hyrjes në xhami: *“Bismillah, Allahumme sal-li ala Muhamed ve sel-lim, Allahumme iftah li eboabe rahmetike”*. Nëse dëshiron të ulesh, atëherë fal në fillim dy rekate që njihen si *“tehijjatul mesxhid”*. Ndërsa, për sa i përket hadithit të përhapur në gjuhët e njerëzve: *“Përsëndetja e shtëpisë (së shenjtë) është tavafi”*, ky hadith nuk ka bazë në sunetin e pastër profetik.
12. Në momentin që sapo shikon Kaben, është mirë që t'i ngresh duart dhe të thuash: *“Allahumme entes salam ve minkes salam fehajjana rabena bis salam”*. Ndërsa për sa i përket fjalës: *“Allahumme innel bejte bejtuke vel haram haramuke ...”* edhe kjo nuk ka bazë në sunetin e saktë profetik.
13. Tavafi.
- Ai është shtatë (7) xhiro rreth Kabes, duke filluar çdo xhiro para gurit të zi dhe duke mbaruar përsëri tek ai.
- Shënim:** Për sa i përket hadithit: *“Guri i zi është nga xheneti dhe ka qenë më i bardhë se bora, derisa e nxinë atë gabimet/mëkatet e pasuesve të shirkut”*, Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Daiffi dobët.”* Shih hadithin me nr. 2767 në *“Daiful Xhami”*. Por, më pas, ai është kthyer nga ky gjykim dhe e ka bërë *hasen*/të mirë këtë hadith. Shih *“Es Siraxhul munir fi tertibi ehadith Sahihul Xhami’s Sagir”*.
14. Personi që kryen umran, gjatë bërjes së xhirove, e lë Kaben nga e majta e tij dhe, para se të filloj tavafin, bën *El Idtibaa’* dhe ajo është që personi të vendosë mesin e *rides* së tij nën shpatullën e tij të djathtë ndërsa cepin e saj mbi shpatullën e majtë. Kjo është e veçantë vetëm për burrat.

³ Buhariu (1540), Muslimi (1184), etj.

15. Nëse të jepet mundësia, e prek gurin e zi me dorën e djathtë, e puth atë dhe bën sexhde mbi të dhe thua: "Bismilah, vAllahu ekber". Nëse nuk mundesh ta bësh këtë, atëherë prej së largu bëja me shenjë atij (gurit) me dorën e djathtë dhe nuk e puth atë, dhe thua: "Bismilah, vAllahu ekber". Disa njerëz shtyhen dhe dërrmohen për të puthur gurin e zi, duke menduar se ai që e bën këtë, ka bereqet. Por, kjo vepër nuk ka bazë në fenë tonë të pastër. Transmetohet nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se: "Ai shkoi te guri i zi, e puthi atë e pastaj tha: 'Unë e di mirë që ti je një gur, që nuk bën dëm e as të sjell dobi. Sikur të mos e kisha parë të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të të puthte, unë nuk do të të puthja." Pas kësaj fillon tavafin (duke e pasur Kaben nga krahu i majtë).⁴

16. *Er Ramelu.*

Dhe ajo është që, në tri xhirot e para të tavafit, personi të nxitojë duke i bërë hapat të vogla dhe afër njëra-tjetrës. Transmetohet nga Abdullah bin Umer (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) se ka thënë: "E pashë të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur hyri në Mekë dhe u kthye nga këndi i gurit të zi (në fillim të tavafit), pastaj eci me ecje të shpejtë në tre xhirot e para."⁵

17. Prej sunetit është që ta prekësh *ruknul jemen*, nëse të jepet mundësia. Nëse nuk mundesh, atëherë mos e përshëndet atë me dorë. Ndërmjet *ruknul jemani* dhe gurit të zi thua: "Rabena atina fid dunja haseneh ve fil ahirati hasene ve kina adhaben nar/O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë si dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit të xhehenemit"

18. Nuk ka ndonjë përmendje apo lutje të veçantë për çdo xhiro të tavafit që bën siç mendojnë disa, por i lejohet muslimanit që të lexojë Kuran në tavafin e tij apo të thotë çfarë të dojë prej lutjeve profetike të sakta.

19. Gjatë tavafit është kusht që personi të jetë i pastër (të ketë abdes). Nëse abdesi i prishet gjatë bërjes së tavafit, atëherë merr përsëri abdes dhe fillo ntek xhiroja që e ka lënë.

20. Kujdes!

Mundohu që gjatë tavafit të mos thuash fjalë të kota, pore merru me du'a, me leximin e Kuranit dhe përmendjen e Allahut. Nuk është e ligjëruar që, gjatë bërjes së

⁴ Buhariu (1597), Muslimi (1270), etj.

⁵ Buhariu (1603), Muslimi (1261), etj.

tavafit, të bësh du'a bashkërisht si dhe ta ngrish zërin. S' ka ndonjë lutje apo përmendje të posaçme gjatë bërjes së tavafit dhe *sajit*.

21. Nuk i lejohet gruas me menstruacione që të bëjë tavafin, derisa ajo të pastrohet.
22. I lejohet gruas që të marrë ilaçe të cilat e ndalojnë ardhjen e menstruacioneve, derisa ajo të plotësojë umran e saj, por me kusht që marrja e këtyre ilaçeve të mos sjelli ndonjë dëm në shëndetin e saj.

Shënim: Kjo është ajo që Allahu ka përcaktuar për vajzat e Ademit, alejhi selam, (gruan). Disa prej dijetarëve e kanë ndaluar marrjen e ilaçeve që ndikojnë në vonimin e menstruacioneve. Madje, edhe disa prej mjekëve e kanë ndaluar këtë, për shkak të dëmit që ato sjellin në shëndetin e gruas.

23. Kush dyshon në lidhje me numrin e xhirove se sa ka bërë, ai kthehet në më të paktën e pastaj plotëson ato që ka mbetur.
24. Nuk preket prej Kabes vetëm se guri i zi dhe *ruknuh jemen* (kjo nëse mundesh), ndërsa ajo që bëjnë disa njerëz duke u kapur pas mbulesës së Kabes, nuk ka aspak bazë në fenë e pastër. Prandaj, largoju kësaj veprë të shëmtuar.
25. Nëse thirrret ikameti për faljen e namazit farz dhe ti je duke bërë tavafin, ndërprite tavafin dhe fal namazin farz me muslimanët e pastaj plotësoje atë që të ka mbetur prej tavafit.

Kujdes: Para se të fillosh namazin, mbuloje krahun e djathtë që e ke zbuluar gjatë bërjes së tavafit e, pas mbarimit të namazit, zbuloje përsëri.

26. Pas mbarimit të shtatë (7) xhirove të tavafit, mbuloje krahun e djathtë.
27. Prej sunetit është që, ai që kryen tavafin, të fali dy rekate pas vendit të Ibrahimit.
28. Në rekatën e parë të lexojë suren "El Kafirun" dhe në rekatën e dytë suren "El Ihlas". Nëse ai nuk mundet të falet pas vendit të Ibrahimit, për shkak se ka shumë njerëz, atëherë ai i fal ato në ndonjë vend tjetër të xhamisë.

Kujdes: Kur të falesh, merr sutër dhe mos neglizho në lidhje me këtë, se nuk ka dallim në marrjen e sutres si në xhaminë e shenjtë, ashtu edhe në xhamitë e tjera.

29. Prej sunetit është që personi, pasi mbaron faljen e dy rekateve, të pi ujë zemzemi dhe të hedhë mbi kokën e tij prej këtij uji. Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!), kur pinte ujë zemzemi, thoshte këtë du'a: "*Allahumme inni eseluke ilmen nafia'n ve rizkan vesia'n ve shifaen min kul-li dain.*"

30. Pastaj shko dhe përshëndet gurin e zi, puthe dhe bjerë në sexhde mbi të, nëse ke mundësi, dhe thuaj: *“Bismilah, vAllahu ekber”*. Pastaj drejtohu për nga Safa për të filluar *sa’jin*.

31. *Es Sajju*.

Është shtatë xhiro ndërmjet Safas dhe Mervas. Fillon prej Safës dhe mbaron te Merva. Kur të afroresh te ajo, lexo Fjalën e Allahut:

"Kodrinat Safa dhe Merva janë pjesë e simboleve të Allahut. Prandaj, ai që viziton Kaben për haxh ose për umre, s'ka kurrfarë gjynahu, nëse sillet mes tyre. Kush bën vepra të mira vullnetare, ta dijë se Allahu është njëmend Falënderues dhe i Gjithëdijshëm." {El Bekare 158}.

32. Pastaj, pas kësaj, thuaj: *“Ebdau bima bedae Allahu bihi/E filloj me atë që Allahu e ka filluar.”*

Ky ajet dhe kjo fjalë nuk thuhet vetëm se ku fillon *sa’jin*, kur afroresh tek Safa.

33. Pastaj ngjitu te Safa duke u drejtuar nga kibla në këmbë –mundohu që të shohësh Kaben- dhe thuaj: *“Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il lAllahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamd, juhji ve jumit ve have ala kuli shein kadir, la ilahe ill Allah vahdehu la sherike leh, enxheze va’dehu ve nasra a’bdehu ve hezeme el ahzabe vehdehu”*. Pastaj ngri duart dhe bëj dua, pastaj thuaj përsëri dhikrin e lartpërmendur pastaj bëj përsëri dua dhe pastaj thuaj dhikrin e lartpërmendur. Pra, dhikër, dua, dhikër, dua, dhikër.

34. Pas kësaj, drejtohesh për nga Merva duke ecur. Nuk ka ndonjë lutje të posaçme që bëhet gjatë kësaj, por bën dhikër dhe lutesh me frikë-respekt për çfarë të duash.

35. Burrat te shenjat dritat jeshile, që janë ndërmjet safës dhe merves, vrapojnë si në vajtje, ashtu edhe në kthim ndërsa gratë ecin normalisht.

36. Në të gjitha xhirot është e pëlqyeshme të thuash: *“Rabbig fir verham inneke ente el ea’zzul ekram”*.

37. Kur të arrish te Merva, e ke plotësuar një xhiro. Prej gabimeve që bien disa njerëz është se ata nga Safa-Merva-Safa e llogarisin një xhiro. Ky është gabim, sepse nga Sava-Merva është një xhiro.

38. Kur të arrish në Merva, vepra njësoj ashtu siç bëre edhe në Safa, duke u drejtuar nga Kibla, dhe fillo me dhikrin dhe lutjen. Pra, dhikër, du'a, dhikër, du'a, dhikër.

39. Vepron në këtë mënyrë, derisa të plotësosh shtatë (7) xhirot. Kur të mbërrish xhiron e fundit në Merva, mos thuaj asgjë prej du'ave dhe dhikrit.

40. Nëse thirret ikameti për faljen e namazit dhe ti je duke bërë *sa'jin*, ndërprite atë dhe shko falu e pastaj, kur të mbarosh namazin, vazhdoje *sa'jin* aty ku e ke lënë.

41. Rruajtja dhe shkurtimi i flokëve.

Rruajtje e flokëve të kokës apo shkurtimi i tyre është prej vaxhibeve të umras.

42. Rruajtja e flokëve është më e mirë sesa shkurtimi i tyre, sepse Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është lutur tre herë për ata që i rruajnë flokët e kokës dhe njëherë për ata që i shkurtojnë. {Buhariu me *Fet'h* nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!), hadithi me nr. 1727 si dhe nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), hadithi me nr. 1728}

43. Është obligim që rruajtja dhe shkurtimi të përfshijë të gjithë kokën dhe nuk mjafton që të rruash apo të shkurtosh një pjesë të saj (kokës) dhe të lësh pjesën tjetër.

44. Nuk i lejohet gruas që t'i rruajë flokët e kokës duke u bazuar në fjalën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

"Për gratë nuk ka rruajtje. Për to ka vetëm shkurtim." ("Sahihu Ebi Daud" 174)

Kujdes: Prej gabimeve që bien disa prej grave është se ato marrin me vete gërshërë dhe i shkurtojnë flokët pas mbarimit të *sa'jit* në sy të burrave të huaj. Ajo që kërkohet prej saj është që flokët t'i shkurtojë, kur të kthehet në vendbanimin e saj (në hotel apo shtëpi).

45. Pas rruajtjes apo shkurtimit të flokëve, personi e heq *ihramin* e tij dhe, me këtë veprim, mbaron umran.

46. Nuk ka tavaf lamtumire, për shkak se nuk ka ardhur ndonjë transmetim për këtë, dhe sahabët nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, me mirësinë e të Cilit plotësohen veprat e mira!